

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6717
E mërkurë, 28 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Krizë mbi krizë deri te rënia e qeverisë

FAQE 5

Shkruan:
Avdullah HOTI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI SHKON NË JAPONI NË KOHË GREVASH, OPOZITA E QUAN TË PAPËRGJEGJSHËM

FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar për në Japoni. Përveç pjesëmarrjes në ceremoninë shtetërore të varrimit të ish-kryeministrit të Japonisë, Shinzo Abe, do të zhvillojë edhe takime zyrtare. Por vizita e Kurtit në Japoni, në kohën kur greva në arsim ka hyrë në javën e pestë, dhe mijëra mësime të

dhe nxënës kanë mbetur jashtë objekteve shkollore, është kritikuar nga partitë opozitare. "Mbi 320 mijë fëmijë tash e një muaj janë pa mësim, rrinë në shtëpi, por kryeministri i Kosovës zgjedh të largohet për në Japoni. Paaftësi dhe papërgjegjësi", ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku

AKTUALE



DASH: SANKSIONET, MJET PËR TA
ÇRRËNJOSUR KORRUPSIONIN NË
BALLKANIN PERËNDIMOR F. 2

TRI PYETJE PËR PROCESIN
E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE F. 3

FILLOI KONFERENCA VJETORE
NDËRKOMBËTARE "FSK DHE
PARTNERËT 2022" F. 3



EKONOMI



LANSOHET PROGRAMI 'BOOST X
KOSOVA' PËR NJË SEKTOR PRIVAT
TË QËNDRUESHËM NË KOSOVË F. 8

SPORT




PRISHTINA DHE DRITA KËRKOJNË
PIKËT E PLOTA NË 'FADIL VOKRRI' F. 10



MCC-ja INVESTON
11 MILIONË EURO NË
EFIÇIENCË, KËRKOHEM
KURSIM I ENERGJISË
DHE PËRKRAHJE NGA
QEVERIA

FAQE 8



NË PRITJE TË VENDIMIT PËR
30 %, VLERA E TRUSTIT BIË

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

DASH: Sanksionet, mjet për ta çrrënjësuar korrupsionin në Ballkanin Perëndimor

WASHINGTON, 27 SHTATOR - Sanksionet janë një mjet i rëndësishëm për ta çrrënjësuar korrupsionin në shtetet e Ballkanit Perëndimor, tha zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price. Ai këto komente i bëri pasi më 26 shtator Departamenti Amerikan i Thesarit vendosi sanksione ndaj prokurores së Shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, Diana Kajmaković.

Price tha se një prej qëllimeve të Shteteve të Bashkuara në Ballkanin Perëndimor është që të punojë me qeveritë për ta luftuar korrupsionin. "Sanksionet do të mbeten një mjet i rëndësishëm, por jo mjeti i vetëm i rëndësishëm kur



bëhet fjalë për rajonin dhe për qëllimin tonë. Këtë qëllim ne e ndajmë me qeveritë dhe banorët e këtij rajoni, pra për ta

çrrënjësuar korrupsionin", tha ai. Sipas njoftimit të Thesarit, Kajmaković u sanksionua për

shkak të "cenimit të vazhdueshëm të demokracisë dhe sundimit të ligjit" në Bosnjë-Hercegovinë.

Kajmaković është zyrtarja e fundit në serinë e disa zyrtarëve në Bosnjë-Hercegovinë dhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor që janë sanksionuar nga ShBA-ja.

Në prill të këtij viti ShBA-ja vendosi sanksione ndaj shtatë personave që u tha se kanë qenë të përfshirë në vepra korruptive. Në mesin e tyre ishin dy shtetas të Shqipërisë, dy zyrtarë të Bosnjë-Hercegovinës, një i Malit të Zi dhe dy në Maqedoninë e Veriut, përfshirë ish-kryeministrin maqedonas Nikolla Gruevski.

Po gjatë vitit të kaluar ShBA-ja ka sanksionuar edhe disa zyrtarë të Bosnjë-Hercegovinës, po ashtu ka zgjeruar sanksionet ndaj liderit të serbëve të Bosnjës, Millorad Dodik, për vepra korruptive.

Dodik fillimisht ishte sanksionuar nga ShBA-ja më 2017.

Po në dhjetor të vitit 2021 Departamenti Amerikan i Thesarit sanksionoi shtatë serbë nga Kosova për përfshirje në aktivitete të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Serbët e sanksionuar janë: Millan Radoičiq, Zvonko dhe Zharko Veselinović, Sërgjan Vulloviq, Zhelko dhe Andrija Bojiq, si dhe Radulle Steviq.

Luftime të ashpra në lindje të Ukrainës



UKRAINE, 27 SHTATOR - Luftime të ashpra midis forcave ukrainase dhe ruse po zhvillohen në disa pjesë në lindje të Ukrainës dhe në rajonin verilindor të Harkivit, teksa Moska po vazhdon shtypjen e protestave kundër mobilizimit ushtarak.

Presidenti Volodymyr Zelensky tha se rajoni lindor i Donjeckut vazhdon të jetë top-prioritet i Ukrainës dhe i Rusisë me luftimet që po zhvillohen në disa qytete, teksa trupat ruse po tentojnë të përparojnë në jug dhe perëndim.

Gjatë një adresimi në orët e vona të 26 shtatorit, Zelensky tha se situata ushtarake në Donjeck është "veçanërisht e rëndë". "Ne po bëjmë gjithçka që ta vëmë nën kontroll aktivitetin e armikut. Ky është

qëllimi ynë kryesor tani, sepse Donbasi vazhdon të jetë qëllimi kryesor i pushtuesve", tha Zelensky. Zyrtarët rajonalë thanë se Rusia ditët e fundit ka kryer të paktën pesë sulme në rajonin e Odesës duke përdorur dronët iranianë.

Raketat ruse kanë goditur aeroportin në Krivi Ri, në Ukrainën qendrore, duke shkatërruar infrastrukturën dhe duke bërë që aeroporti të dalë jashtë funksionit, tha Valentyn Reznichenko, guvernator i rajonit Dnipropetrovsk.

Komanda jugore e forcave të armatosura të Ukrainës tha më 27 shtator se kundëroffensiva në rajonin juglindor të Hersonit ka rezultuar me vrasjen e 77 ushtarëve

të armikut, shkatërrimin e gjashtë tankeve, pesë obusëve, tri armëve kundërajrore dhe 14 makinave të blinduara.

Këto pretendime nuk kanë mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur.

Luftime, po ashtu, janë raportuar në rajonin e Harkivit, rajon në verilindje të Ukrainës që ka qenë në shënjestër të kundëroffensivës që Kiev ka nisur gjatë këtij muaji.

Ndërkaq, forcat ukrainase kanë vazhduar fushatën e tyre për të shkatërruar katër ura, me qëllim që t'i ndërpresin linjat e furnizimit për forcat ruse në jug të vendit.

Në Rusi njoftimi për mobilizimin e 300 000 rezervistëve ka nxjerrë protestat më të mëdha që nga nisja

e pushtimit të paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt.

Organizata që monitoron arrestimet politike në Rusi, OVD-Info, tha se më 25 shtator janë arrestuar 2 353 persona, ndërkaq më 26 shtator u arrestuan edhe të paktën 141 protestues të tjerë. Në këtë shtet, kritikant ndaj "operacionit të posaçëm ushtarak" të Rusisë janë të ndaluara.

Duke cituar zyrtarë të pidentifikuar, dy medie ruse që veprojnë jashtë vendit - Meduza dhe Novaya Gazeta Europe - raportuan se autoritetet po planifikojnë që burrave t'ua ndalojnë largimin nga vendi, teksa radhët e gjata të makinave po shihen në pikat kufitare.

Raportohet se radhët në kufirin midis Rusisë dhe Gjeorgjisë janë të gjata 48 orë. Shtetasit rusë mund të hyjnë në Gjeorgjinë fqinje pa pasur nevojë për vizë.

I pyetur për mundësinë e mbylljes së kufirit, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u tha gazetarëve më 26 shtator se "unë nuk di asgjë për këtë çështje deri në këto momente. Aktualisht nuk ka ndonjë vendim për këtë gjë".

Në Uashington, zëdhënësjë e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre, tha se Shtetet e Bashkuara do t'i shqyrtojnë aplikimet për azil të rusëve që po ikin nga mobilizimi i pjesshëm ushtarak që presidenti rus Vladimir Putin shpalli më 21 shtator.

Tri pyetje për procesin e liberalizimit të vizave

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën, që do t'u mundësonte qytetarëve të saj lëvizje të lirë në dhjetëra vende të Evropës, zgjat tash e dhjetë vjet. Tani duket se është në fazën finale. Republika Çeke, e cila aktualisht ka kryesimin e Bashkimit Evropian, ka paralajmëruar se diskutimi në Këshillin e BE-së për këtë proces do të nisë më 13 tetor. Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian kanë mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën qysh në vitin 2018. Por, instanca e fundit është Këshilli i BE-së, apo vendet anëtare.

Çfarë do të ndodhë e çfarë jo më 13 tetor?

Në këtë datë, nëse nuk ndryshon plani, grupi punues për vizat në Këshill do të ketë në rend dite - për herë të parë - temën e liberalizimit të vizave për Kosovën. Ky do të jetë fillimi i procesit në Këshill dhe jo fundi i tij, pasi në këtë datë do të nisë procedura, e cila do të çojë drejt vendimit formal për liberalizimin e vizave.

Cilët do të jenë hapat pas diskutimeve në Këshillin e BE-së?

Në takimin e grupit punues për vizat në Këshill do të shqyrtohet raporti i përditësuar teknik nga Komisioni Evropian për përbushjen e kushteve nga ana e Kosovës. Nëse ka pajtim mes vendeve anëtare të BE-së, atëherë tek ambasadorët e

këtyre vendeve do të bartet përgjegjësia që ta japin dritën e gjelbër për nisjen e diskutimeve trepalëshe - mes Parlamentit Evropian, Këshillit të BE-së dhe Komisionit Evropian.

Marrë parasysh se Komisioni dhe Parlamenti nuk kanë asnjë rezervë për liberalizimin e vizave për Kosovën, kjo procedurë pritet të përmbyllet shpejt.

Kur në këto diskutime të arrihet pajtimi, atëherë të njëjtin do ta konfirmojnë formalisht edhe ambasadorët e vendeve anëtare.

Kjo mund të ndodhë në muajin nëntor, nëse ka vullnet politik.

Vendimi, më pas, votohet në komisionin përkatës të Parlamentit Evropian, e pastaj edhe në seancë plenare.

Pasi Parlamenti të votojë formalisht, përfaqësuesit e vendeve anëtare, me shumicë të kualifikuar, votojnë, po ashtu, për këtë vendim.

Hap i radhës është konfirmimi i vendimit edhe nga ministrat e vendeve anëtare në Këshill.

E gjithë kjo, sipas pritjeve të disa diplomatëve evropianë, mund të ndodhë deri në fund të këtij viti.

Hapi i fundit, pastaj, është botimi i vendimit në Gazetën Zyrtare të BE-së, me çka edhe caktohet data e hyrjes në fuqi të vendimit.

A ekziston mbështetja e vendeve anëtare në Këshill?

Mbështetja nga shumica e vendeve anëtare ekziston tash e një kohë të gjatë. Por, për shkak të



kundërshtimeve apo rezervave nga disa vende të rëndësishme, si Franca dhe Holanda, liberalizimi i vizave për Kosovën nuk është vënë në rend dite në Këshill.

Tash, sipas vlerësimeve të diplomatëve, mbështetja është rritur shumë. Për më tepër, disa burime thonë se, kohëve të fundit, nuk është dëgjuar asnjë zë kundër nga vendet anëtare. Këto qëndrime janë shprehur edhe në takime të ndryshme të nivelit politik. Megjithatë, diskutimet në grupin punues në Këshill dhe më pas në mes të ambasadorëve do të

jenë testi kryesor i disponimit të vendeve anëtare.

Diplomatët në Bruksel vlerësojnë se janë dy arsye kryesore që shkojnë në favor të liberalizimit të vizave.

Një është fakti se Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret teknike nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave. Komisioni Evropian e ka konfirmuar këtë - gjë për të cilën pajtohen tani edhe shumica e madhe e vendeve anëtare.

Arsye e dytë është ai që vlerësohet si moment i përshtatshëm politik,

në të cilin BE-ja, përmes liberalizimit të vizave për Kosovën, dëshiron të dëshmojë se është e përkushtuar ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe është e gatshme t'i shpërblejë ato vende që i përbushin kriteret dhe shënojnë përparim.

Në këto argumente është thirrur edhe Presidenca çeke e Këshillit të BE-së kur ka kërkuar nga vendet anëtare që të mbështesin liberalizimin e vizave për Kosovën - vendin e vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk gëzon ende një regjim të tillë.

Filloi konferenca vjetore ndërkombëtare "FSK dhe partnerët 2022"

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Nën organizimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, ka filluar të martën konferenca vjetore ndërkombëtare "FSK dhe partnerët 2022", e cila do të zgjasë dy ditë.

Në ditën e parë të kësaj konference morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendësiministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, zëvendëskomandanti i FSK-së,

gjeneralmajor Enver Cikaqi, shefi i shtabit të KFOR-it, gjeneralbrigade John B. Bozicevic, drejtori i NALT-it, gjeneralbrigade Joachim Hoppe, zyrtarë dhe oficerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, ambasadorë, atashe të mbrojtjes si dhe përfaqësues të tjerë diplomatikë dhe ushtarakë të të gjitha shteteve partnere.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, ministri Mehaj ka theksuar se së bashku me shtetet partnere do ta zhvillojnë FSK-në për mbrojtjen e vendit për ta jetësuar vizionin për anëtarësim

në NATO. "Falënderoj të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët me praninë e tyre në këtë konferencë dhe me mbështetjen e tyre të pandërprerë, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, kanë kontribuar në forcimin e FSK-së, ku si rezultat FSK-ja është në gjendje ta japë përkushtimin, profesionalizimin dhe disiplinën, duke dëshmuar se mund të kontribuojë për paqen dhe sigurinë edhe në nivel ndërkombëtar", ka theksuar ministri Mehaj, duke u shprehur falënderim të veçantë ShBA-së

dhe aleatëve të tjerë evropianë për kontributin e tyre të pazëvendësueshëm për forcimin e FSK-së si dhe në procesin e suksesshëm të zbatimit të Planit Gjithëpërfshirës 10-vjeçar të tranzicionit.

Ndërsa zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, u shpreh i bindur se kjo konferencë ndihmon në ngritjen dhe thellimin e aktiviteteve të ndërsjella dhe në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të FSK-së. Me fjalë rasti të pranishmëve iu drejtuan edhe shefi i shtabit të

KFOR-it, gjeneralbrigade John B. Bozicevic, drejtori i NALT-it, gjeneralbrigade Joachim Hoppe, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott dhe ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar.

Konferenca ndërkombëtare "FSK dhe partnerët 2022" do të vazhdojë edhe të mërkurën, me sesionet punuese në nivel të takimeve me përfaqësuesit e vendeve partnere veç e veç, për sinkronizim të konceptplaneve për periudhën pasuese njëvjeçare.



Opozita kritikon Kurtin për vizitën në Japoni në kohë grevash, e quan kryeministër të papërgjegjshëm

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar për në Japoni. Përveç pjesëmarrjes në ceremoninë shtetërore të varrimit të ish-kryeministrit të Japonisë, Shinzo Abe, do të zhvillojë edhe takime zyrtare. Por vizita e Kurtit në Japoni, në kohën kur greva në arsim ka hyrë në javën e pestë, dhe mijëra mësimit dhe nxënës kanë mbetur jashtë objekteve shkollore, është kritikuar nga partitë opozitare. “Mbi 320 mijë fëmijë tash e një muaj janë pa mësim, rrinë në shtëpi, por kryeministri i Kosovës zgjedh të largohet për në Japoni. Paaftësi dhe papërgjegjësi”, ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Viti shkollor në Kosovë nis më 1 shtator, por është gati fundi i muajit dhe mbi 300 000 nxënës ende mbeten jashtë bankave të klasës. Punonjësit e arsimit janë në grevë. Ata po kërkojnë mbështetje financiare prej 100 eurosh në muaj derisa të hyjë në fuqi Ligji për Paga. Qeveria e Kosovës thotë se ky ligj, që parasheh rritje pagash për punonjësit e sektorit publik, do të dalë në miratim së shpejti dhe kërkon nisjen e mësimin.

Liderët e partive opozitare sërish të martën e kanë kritikuar kryeministrin Kurti për grevën në arsim, duke e bërë fajtor për mosgjatjen e një zgjidhjeje për ta filluar mësimin.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se shkollat Kurti i mbylli për nxënës, por i hapi për zgjedhje të Vetëvendosjes. “Për Albin Kurtin, karriget e pushtetit janë më të rëndësishme se karriget e nxënësve tanë që po vazhdojnë të mbesin të

mbyllur në shtëpi për shkak të arrogancës së tij. E kam thënë edhe në Kuvend, se kryeministri merret me armiq imagjinarë e jo me probleme të qytetarëve. Në krizën më të madhe të arsimit, që nga vitet '90, kryeministri ushqen fantazitë e tij, larg brengave dhe problemeve që po rriten çdo ditë në Kosovë. Tamam si një Don Kishot që lufton me mullinjë e erës. Tash e paska quajtur SBASHK-un sindikatë e PAN-it. Cilit PAN?! Nuk ka PAN. Ka grevë! SBASHK-u nuk po tregohet partner fleksibil, por gatismëria që fëmijët të vuajnë, vetëm që Albin Kurti të quhet i ‘pathyeshëm’ nga militantët e tij, është mentalitet diktatorial”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Lideri i PDK-së ka thënë se beson se qytetarët nuk kanë votuar që të kenë një kryeministër i cili e lë popullin pa arsim e fëmijët pa shkollim. “Jam i bindur se qytetarët nuk kanë votuar që sot të përballen me këtë mentalitet dhe tendencë të kryeministrit për t'i nënshtruar të gjithë. Sot, më shumë se kurrë, Kosova ka nevojë për zgjidhje konkrete të problemeve, jo për fjalë

të thata e inate. Ka nevojë për leadership që e ruan dinjitetin e secilit qytetar e jo për lider që krijon ndasi edhe më të mëdha në shoqëri. Lëviz nga vendi, kryeministër! Ofro zgjidhje! Ktheji fëmijët në shkollat”, ka shkruar Krasniqi.

Edhe nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, këtë situatë e ka quajtur indiferencë dhe mungesë totale të empatisë. “Jo vetëm paaftësi, por edhe më keq. Indiferencë. Mungesë totale e empatisë. 320 000 fëmijë kanë mbetur tash e një muaj pa shkollë. E kryeministri? Në Japoni”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”.

Për grevën në arsim ka reaguar edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku. “Mbi 320 mijë fëmijë tash e një muaj janë pa mësim, rrinë në shtëpi, por kryeministri i Kosovës zgjedh të largohet për në Japoni. Paaftësi dhe papërgjegjësi! Ky njeri nuk di të qeverisë! Asnjëherë në Kosovë, në kohë paqeje, mësimi nuk është ndërprerë kaq gjatë”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”. Ai ka theksuar se asnjëherë më

parë fëmijët nuk kanë pësuar me kaq pandjeshmëri. “Kjo më nuk është gjendje normale. Fëmijët, familjet, mësimit dhe vet shteti s'mund të dëmtohen me kaq lehtësi. Kujt i duhen fajësimet, ofendimet e egot individuale kur në fund mbesin në krizë? Kosova ka nevojë për vëmendje e udhëheqje të matur politike. Kosova ka nevojë për leadership që jep zgjidhje, menaxhon kriza e përgatit vendin për betejat e mëdha përpara - në energjetikë, inflacion, shëndetësi dhe ekonomi. Ikja nga këto ballafaqime është veç

papërgjegjësi”, ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Rrahman Jasharaj, ka thënë se fajtorë për mbylljen e shkollave është qeveria, e cila, sipas tij, “nuk reflekton karshi kërkesave të sindikalistëve”. Në fillim të këtij muaji, Qeveria e Kosovës ka paraqitur një pako për përballje me inflacionin, në kuadër të së cilës punonjësit e sektorit publik, përfshirë mësimit, përfitojnë nga 50 euro shtesë nisur nga ky muaj. Sindikata e Arsimit nuk e ka pranuar këtë “ofertë”.

Myftiu Tërnavë bën thirrje për ndërprerje të grevës dhe miratim të Projektligjit për Paga

Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, u ka bërë thirrje të punësuarve në arsim dhe shërbyesve civilë që ta ndërpresin grevën. Në një konferencë për medie mbajtur të martën, Tërnavë, teksa i ka bërë thirrje SBASHK-ut dhe Sindikatës së Shërbyesve Civilë për ndërprerje të grevës, Qeverisë së Kosovës i ka kërkuar që sa më parë ta miratojë Ligjin e Pagave. “Me vëmendje kam përcjell zhvillimet që kanë të bëjnë me grevën. Mbështesim kërkesën e mësimit dhe shërbyesve për pagë të dinjitetshme, pasi kanë mision të shenjtë. Thërras SBASHK-un që për hir të

misionit që bart mbi vete, sot ta ndërpresë grevën dhe nesër fëmijët tanë t'u kthehen bankave shkollore, aty ku e kanë vendin. Gjithashtu, thërras Sindikatën e Shërbyesve Civilë që ta ndërpresë grevën dhe të kthehet në vendin e punës në mënyrë që institucionet e shtetit të ç'bllokohen. Ndërsa i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës që ta miratojë sa më parë Ligjin e Pagave dhe të merren parasysh kërkesat e grevistëve. Të gjithë jemi të bindur se nuk është koha për përplasje dhe barrikadim, por për unitet veprues”, ka thënë Tërnavë.

Krizë mbi krizë deri te rënia e qeverisë



Shkruan: Avdullah HOTI

1. Krizë në arsim:

Një muaj nxënësit rrinë në shtëpi. Në vend që të dialogohet 24 orë deri të gjendet zgjidhja,

qeveria bën luftë me sindikata. Shtyhet Ligji i Pagave pa nevojë, por as nuk plotësohet kërkesa e sindikatave për 100 euro shtesë në muaj, edhe pse e realizueshme në aspektin buxhetor.

2. Krizë në shëndetësi:

Ministri i Shëndetësisë është non-ekzistent. Ai është ministër me korrespondencë. Si rezultat, kryeministri merr përsipër detyrat e ministrit duke kryesuar vetë një komision qeveritar për shëndetësi.

3. Krizë në politikën e jashtme:

Asnjë njohje apo anëtarësim për një vit e gjysmë. Shumë ambasada, e në veçanti ato në vendet kryesore mike, janë me mungesë të stafit esencial. Grevë e stafit të MPJ-së për shkak të trajtimit joadekuat. Gafa të vazhdueshme të ministres dhe mungesë elementare e njohurive në diplomaci.

4. Krizë në ekonomi:

Qeveria nuk e ka idenë se si të përballohen inflacioni i lartë dhe kriza energjetike. Nuk ka

konsultime me komunitetin e biznesit. Investimet e jashtme më të ulëta se në vitin 2019. Shpenzimet kapitale të qeverisë në nivelin më të ulët që ka qenë ndonjëherë, me vetëm 9 %. Papunësia mbetet aty ku ka qenë më 2019. Bilanci bankar i qeverisë arrin në 600 milionë euro, me kosto të mëdha oportune për qytetarët dhe bizneset.

5. Dialogu në udhë pa krye:

Përveç një togfjalëshi absurd se "njohja duhet të jetë në qendër", (pse jo në lindje apo perëndim, në

të djathtë apo në të majtë, në fillim apo në fund?), që përsëritet pa pushim, tjetër parim të dialogut nuk ka. Askush nuk di se çfarë po bisedohet. I kanë sharë marrëveshjet e mëparshme e tash ato dolën që janë të duhura për ta vendosur sovranitetin shtetëror në tërë territorin. Deklarimet e forta se: nuk ka dialog me Serbinë, por me serbët lokalë, se nuk ka dialog pa kërkim falje, nuk ka dialog pa zbardhjen e fatit të të pagjeturve e të tjera, u harruan plotësisht. Vendin e tyre e zunë darkat e përbashkëta.



Kurti në Japoni diskuton për marrëdhëniet mes dy vendeve dhe investimet në fushën ekonomike

TOKIO, 27 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Financave, Punës dhe Trasfereve, Hekuran Murati dhe ambasadori i Kosovës në Japoni, Sabri Këçmar, ka filluar të martën vizitën dyditore në Japoni me rastin e ceremonisë lamtumirës dhe funeralit shtetëror në nderim të ish-kryeministrit të Japonisë, Shinzo Abe. Në ditën e parë të qëndrimit atje, ai është pritur nga kryetari i Kuvendit të Japonisë, Hiroyuki Hosoda. Në

këtë takim është diskutuar për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, investimet në fushën ekonomike dhe tregtare, si dhe për rrethanat gjeostrategjike.

Kryeministri Kurti e ka ngushëlluar kryetarin Hosoda me rastin e vdekjes së ish-kryeministrit Shinzo Abe, duke vlerësuar lart rolin e ish-kryeministrit Abe për paqen dhe demokracinë në botë dhe duke shprehur konsiderata të larta për miqësinë e treguar për popullin e

Kosovës dhe për rolin e tij përmes iniciativës japoneze bashkëpunuese për Ballkanin Perëndimor.

Gjatë takimit Hosoda është njoftuar për sukseset në Kosovë, punën paralele në rrafshin demokratik dhe zhvillimor dhe për rritjen ekonomike mbi 10 %.

Sa i përket invazionit të paprovokuar të Federatës Ruse në Ukrainë, kryeministri Kurti ka theksuar se Kosova iu është bashkuar ShBA-së, BE-së,

Japonisë dhe vendeve të tjera demokratike, duke vendosur sanksione kundër Rusisë dhe duke mbështetur popullin e Ukrainës.

Kryeministri Kurti ka shprehur pikëpamje të njëjta me palën japoneze lidhur me gjeopolitikën aktuale.

Kryetari i Kuvendit të Japonisë, Hiroyuki Hosoda, e ka falënderuar kryeministrin Kurti për vizitën. Ai ka thënë se i kujtohet shumë mirë gjendja e refugjatëve të Kosovës në

Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut gjatë luftës në Kosovë, të cilët i ka vizituar gjatë vitit 1999, duke parë e përjetuar nga afër vuajtjet e tyre. Kryetari i Kuvendit japonez ka përsëritur konfirmimin e pjesëmarrjes së Kosovës në Osaka Expo 2025. Në takim, po ashtu, është biseduar edhe për rëndësinë e thellimit të marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare, si dhe për bashkëpunimin në fushën e TIK-ut dhe të mbrojtjes nga sulmet kibernetike.

Në pritje të vendimit për 30 %, vlera e Trustit bie

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Në kohën kur tërheqja e parave nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës është sërish në diskutim, vlera e këtij fondi është më e vogël për disa milionë euro.

Tash e sa muaj kërkesë e opozitës në Kosovë është t'u mundësohet qytetarëve të tërheqin deri në 30 për qind të mjeteve nga Fondi, për ta përballuar, siç thuhet, më lehtë inflacionin në rritje.

Projektligji që do ta mundësonte këtë, ka dalë në votim në Kuvendin e Kosovës në muajin qershor, por është refuzuar nga partia në pushtet - Lëvizja Vetëvendosje - me arsyetimin se "do ta shkatërronte strukturën pensionale të shtetit".

Javën e kaluar kryesia e Kuvendit të Kosovës vendosi ta dërgojë në qeveri për mendim këtë projektligji, bazuar në një peticion të nënshkruar nga më shumë se 20 mijë qytetarë të Kosovës, i cili i është dorëzuar Kuvendit më 15 korrik.

Nuk është ende e qartë se kur mund ta japë qeveria mendimin. Po ashtu, nuk dihet nëse projektligji do të arrijë sërish në Kuvend.

Në një anketë të mëhershme të "Radios Evropa e Lirë", qytetarët pjesëmarrës janë shprehur për dhe kundër tërheqjes së mjeteve.

Mbi 160 milionë euro më pak

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, i njohur edhe si Trusti, mbledh mjetet e kontribut-paguesve kosovarë. Shuma e tij arrin në gati 2.3 miliardë euro por, aktualisht, është më e vogël për më shumë se 160 milionë euro.

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, rënia në vlerë ka ndodhur gjatë muajve të fundit për shkak të zhvillimeve gjeopolitike, përfshirë luftën në Ukrainë, krizën energjetike dhe inflacionin dyshifror. Të gjitha këto kanë shkaktuar çrregullime në tregjet ndërkombëtare. "Sfidat e performancës së sektorit pensional të Kosovës janë shtuar theksueshëm për vitin 2022", thuhet në një raport të BQK-së të publikuar pak javë më parë.

Me ligjet në Kosovë, 70 për qind e mjeteve të Trustit janë të investuara në tregjet financiare ndërkombëtare në periudha afatgjatë, me qëllim që t'u rritet vlera, ndërsa 30 për qind investohen në letrat me vlerë në Kosovë.

Të gjithë të punësuarit në Kosovë



janë të obliguar të paguajnë 10 për qind kontribute pensionale nga paga e tyre: 5 për qind i paguan punëdhënësi, kurse 5 për qind ndahen nga paga e të punësuarit. Kursimet pensionale mund të përdoren nga kontribuuesi vetëm pasi t'i përmbushë kushtet për pensionim, përkatësisht arrijen e moshës 65-vjeçare.

A dëmtohen kontribut-paguesit?

Zëdhënësi i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Jeton Demi, thotë se lëvizjet e fundit në tregjet financiare nuk do t'i prekjin personat që janë afër pensionimit. "Mjetet e dedikuara për kontribuuesit e moshës 63-vjeçare e gjysmë janë të investuara në letrat me vlerë të Kosovës, që kanë interes të paracaktuar. Për këtë vit, kishte kthim pozitiv nga investimet - afro 2 për qind", thotë Demi për "Radion Evropa e Lirë".

Letrat me vlerë ose bonot e

Thesarit lëshohen nga Ministria e Financave dhe Transfereve e Kosovës sa herë që qeveria ka nevojë për më shumë para.

Demi thotë se pjesa tjetër e kontribut-paguesve - ata nën 63 vjeç e gjysmë - do të ketë kohë të rikuperohet, bashkë me lëvizjen e tregjeve.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës nuk e konsideron humbje rënien aktuale të investimeve, duke shprehur bindjen se ajo do të rikuperohet, përkatësisht rritet në të ardhmen.

Bektashi: Jo më shumë se deri në 10 % t'u shpërndahen kontribut-paguesve

Ekspertë të çështjeve ekonomike thonë se derisa çrregullimet në tregjet ndërkombëtare të vazhdojnë, paratë e kontribut-paguesve do të shënojnë humbje.

Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejdi

Bektashi, thotë se do të ishte mirë që kontribut-paguesve kosovarë t'u mundësohet tërheqja e një pjese të kursimeve pensionale. Kjo, për shkak edhe të, siç thotë ai, gjendjes së rënduar ekonomike nga rritja e inflacionit.

Norma e inflacionit në Kosovë në muajin gusht ka arritur në 13 për qind krahasuar me 0.2 për qind sa ka qenë në gushtin e vitit të kaluar. "Do të ishte mirë që një pjesë, jo më shumë se deri në 10 për qind, t'u shpërndahet pronarëve të atyre mjeteve. Kjo do të kishte efekt edhe në qarkullimin e mjeteve në tregun e Kosovës", thotë Bektashi për "Radion Evropa e Lirë".

Çfarë thotë FMN-ja?

Por, përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, gjatë një takimi me zyrtarë të Bankës Qendrore të Kosovës më 21 shtator, janë shprehur kundër tërheqjes së mjeteve nga Trusti, duke thënë se ky veprim do të shkaktonte një "goditje të rëndë

mbi qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve" dhe "do ta reduktonte vlerën reale të pensioneve". Në një hulumtim të bërë më herët nga Instituti për Studime të Avancuara GAP në Prishtinë, thuhet se nëse qytetarët e Kosovës do të tërhiqnin 30 për qind të mjeteve që kanë grumbulluar, atyre do t'u duhen tetë vjet për t'i rikthyer ato. Sipas këtij hulumtimi, në rast se miratohet projektligji për tërheqje, Trusti do të obligohet t'i fillojë procedurat për shpërndarjen e mbi 594 milionë eurove.

Në vitin 2020 qytetarëve të Kosovës u është mundësuar të tërheqin 10 % të kursimeve të tyre nga Trusti. Kjo është bërë me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, qëllim i të cilit ka qenë adresimi i vështirësive financiare, të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit.

Asokohe nga Trusti janë tërhequr rreth 200 milionë euro nga mbi 420 mijë kontribut-pagues. Fondi Monetar Ndërkombëtar edhe atëherë ka qenë kundër.

Mbahet Kuvendi Zgjedhor i nëndegës së PDK-së për Paris

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) po vazhdon shtrirjen dhe organizimin e strukturave partiake. "Pas formimit të Këshillit për organizimin e kuvendit të degës së PDK-së në Francë, tashmë kemi edhe nëndegën e parë në kryeqytetin e Francës", ka shkruar në "Facebook" Elmi

Reçica, udhëheqës i Departamentit për Diasporë. Ai ka theksuar se me këtë rast, pas një procesi të rregullt dhe të brendshëm zgjedhor, u zgjodh kryetari i nëndegës, biznesmeni i shquar Lulzim Berisha, si dhe anëtarët e kryesisë, Idriz Çitaku, Afrim Krasniqi, Shpetim Bardhi, Blerim Berisha, Arben Canolli,

Isuf Brahimi, Xhavit Krasniqi, Avni Fazliu, Ilaz Azemi dhe Ukshin Skenderi. "Po ashtu u zgjodhën edhe delegatët për Kuvendin Zgjedhor të Degës së PDK-së në Francë. Uroj dhe përgëzoj themelimin e nëndegës, zgjedhjen e Lulzim Berishës kryetar, si dhe anëtarët e tjerë", ka shkruar Reçica.



Vazhdojnë punimet për rregullimin e infrastrukturës brenda kazermave të FSK-së

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka bërë me dije se, krahas blerjes së pajisjeve ushtarake, po vazhdojnë punimet intensive për rregullimin e infrastrukturës

së nevojshme brenda kazermave të FSK-së. “Në kuadër të kësaj në kazermën ‘Skënderbeu’ në Ferizaj po vazhdojnë punimet për ndërtimin e depos së logjistikës që do t’i

përmbushë nevojat e Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes për sistemimin e pajisjeve. Ky projekt që është dyvjeçar pritet të përfundojë brenda pak muajsh”, ka shkruar Mehaj në “Facebook”.



Mbrojtja kërkon lirimin e Selimit deri në 30 ditë para gjykimit



HAGË, 27 SHTATOR - Mbrojtja e ish-deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, në përgjigje ndaj kërkesës së Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), ka kërkuar lirimin e Selimit deri në 30 ditë para gjykimit. Kështu është bërë me dije nëpërmjet shkresës së publikuar në faqen e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, në të cilën thuhet se kushtet e gjera, të arsyeshme, reale dhe të detyrueshme të lirimit të përkohshëm, mund t’i zbusin mjaftueshëm gjasat e rreziqeve të identifikuar nga gjyqtari i procedurës paraprake. Sipas mbrojtjes, gjyqtari i procedurës paraprake duhet ta refuzojë kërkesën e ZPS-së për vazhdimin e paraburgimit të Selimit i cili po akuzohet për krime lufte.

Mbrojtja rikujton se Kolegji i Apelit miratoi qasjen e gjyqtarit të procedurës paraprake gjatë

vlerësimit të kushteve të propozuara të lirimit i cili: “nuk ka vendosur një standard që do të përmbushë vetëm kur mbrojtja e ofruar nga Policia e Kosovës ishte ekuivalente me atë të objekteve të paraburgimit, por e përdori atë si një metodë për ta vlerësuar përshtatshmërinë e kushteve të propozuara në drejtim të zbutjes së rreziqeve të identifikuar”, shkruan “Betimi për Drejtësi”. “Për ta lejuar lirimin e përkohshëm sipas kushteve, gjyqtari i procedurës paraprake nuk duhet të jetë i bindur se kushtet do të përsërisin saktësisht ato në objektin e paraburgimit të DhSK-së por, përkundrazi se, të vlerësuar në mënyrë holistike, kushtet e kombinuara të lirimit do t’i zbusin mjaftueshëm rreziqet e nenit 41(6)(b). Kushtet e kombinuara të përcaktuara këtu, të cilat do të vendosnin kufizime të rënda dhe të gjera

për lirinë e z. Selimi, do ta përmbushnin atë standard”, thuhet tutje.

Ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) do të përballen edhe me akuzat të tjera që pritet t’ua rëndojnë rastin.

Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit pritet që t’u rëndohen akuzat për krime të luftës, kësaj here nën pretendimet se janë kryer në fshatrat Semetishtë e Budakovë të Suharekës. “Anëtarët e UÇK-së ua hoqën lirinë së paku 12 personave pa një proces të rregullt ligjor, duke i mbajtur ata në lokacione në Budakovë/Budakovo1 dhe Semetishtë/Semetište në periudha të ndryshme ndërmjet 4 korrikut 1998 dhe 29 prillit 1999”, thuhet në anekset e aktakuzës, sipas faqes zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në anekset e aktakuzës, pa

përmendur emra, thuhet se pjesëtarët e UÇK-së u kanë shkaktuar viktimave lëndime fizike dhe psikike. “Anëtarët e UÇK-së shkaktuan vuajtje ose lëndime serioze mendore ose fizike, ose sulmuan seriozisht dinjitetin njerëzor të viktimave duke i ndaluar në mënyrë arbitrare (shih Pikën 3). Anëtarët e UÇK-së, gjithashtu, u shkaktuan viktimave vuajtje ose lëndime të rënda mendore ose fizike, ose sulmuan seriozisht dinjitetin e tyre njerëzor, duke i keqtrajtuar dhe/ose përmes kushteve të cilave iu nënshtruan viktimave gjatë ndalimit të tyre”, thuhet në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara. Një pesë e madhe e këtyre anekseve janë të redaktuara, që i bie se publiku i gjerë nuk ka qasje në shumë prej detajeve, siç janë emrat e shumë personave të përmendur.

Në aneksin 7 të aktakuzës së

publikuar flitet edhe për një rast që supozohet se ka ndodhur në një konvikt në komunën e Gjilanit. Sipas këtij aneksi, viktimat supozohet të ketë qenë civil dhe jo në uniformë ushtarake. “Në fund të korrikut 1999, [redaktuar] u dërgua me veturë nga vendi i tij i punës në Konviktin e Gjilanit/Gnjilane. 2 Në konvikt ai u kontrollua dhe iu morën çelësat e makinës dhe karta e identifikimit dhe iu gris patenta e shoferit. 4 Atij nuk iu tha arsyeja e ndalimit apo arrestimit dhe nuk u akuzua për kryerjen e ndonjë krimi”.

Për këto ankesa të reja të aktakuzës, Dhomat e Specializuara kanë caktuar katër seanca ku të akuzuarit do të deklarohen për fajësinë. Deri më tash asnjë nga të akuzuarit e Gjykatës Speciale nuk e ka pranuar fajësinë. Të gjithë, pa përjashtim, janë deklaruar të pafajshëm para trupit gjykues.

Gjykata Speciale ia vazhdon paraburgimin Kadri Veselit

HAGË, 27 SHTATOR - Ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit, i është vazhduar

paraburgimi në Hagë. Lajmin e ka dhënë Gjykata Speciale. Arsyet e vazhdimin të

paraburgimit mbesin të njëjta: rreziku i ikjes, ndikimit në dëshmitarë, shkatërrimi i

provave ashtu siç rëndom i ka bërë Prokuroria e Specializuar e i ka aprovuar gjykata.



MCC-ja investon 11 milionë euro në efijencë, kërkohet kursim i energjisë dhe përkrahje nga qeveria

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), i mbështetur nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) dhe komunat, kanë zbatuar projektin Subvencione për Efijencë të Energjisë në Kosovë (SEEK), një aktivitet testues prej 20 milionë dollarësh, që kishte për qëllim ta zvogëlojë hendekun ndërmjet kërkesës dhe ofertës për energji. Me këtë rast është mbajtur konferenca "Roli i sektorit privat në promovimin e energjisë efijente në Kosovë". Petrit Selimi, kryeshef i Fondacionit të Mileniumit të Kosovës (MFK), ka thënë se qëllim kanë t'i ndihmojnë institucionet që t'i destinojnë investimet në efijencë të energjisë. Ai ka thënë se janë ndarë 11 milionë euro për kursimin e energjisë, duke shtuar se projekti ka nisur para tri vjetësh. Kjo konferencë ka ofruar një

platformë për më tepër se 100 partnerë të sektorit të biznesit dhe instalues të certifikuar për shkëmbimin e përvojave, për identifikimin e energjive të reja potenciale si dhe për zhvillimin e modeleve mbështetës për institucionet e Kosovës për një efijencë më të madhe të energjisë.

Ndërsa Getoart Mjeku, zëvendësministër i Ekonomisë, ka thënë se në kohë të krizës energjetike, është i nevojshëm investimi në energjinë efijente. Në anën tjetër, Kevin Mitchell, drejtor menaxhues i operacioneve sektoriale, ka thënë se janë testuar numër i madh i shtëpive me qëllim të kursimit të energjisë, duke izoluar ato.

Më tutje, Ulrich Theuerkauf, drejtor i Departamentit të Energjisë në GFA (Consulting Group GmbH), ka thënë se projekti ka nisur qysh në vitin 2011. Ai ka kërkuar nga qeveria që të investojnë në këtë sektor. "Që nga viti 2011 ka filluar ky projekt me izolimin e shtëpive për efijencën e energjisë e në



vitin 2022 punimet na është dashur t'i ndalojmë për shkak të Covid-19, por më në fund e

kemi përfunduar dhe sot po festojmë për arritjet tona. I kërkoj qeverisë ta mbështetë

projektin për efijencën e energjisë elektrike", ka thënë Theuerkauf.

Lansohet programi 'Boost x Kosova' për një sektor privat të qëndrueshëm në Kosovë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, në partneritet me Ambasadën e Japonisë në Kosovë, ka lansuar 'Boost x Kosova', një program akselerator, që do t'u ndihmojë bizneseve t'i tejkalojnë sfidat dhe të arrijnë qëndrueshmëri përmes integritit të praktikave të gjelbra dhe të qëndrueshme. Duke folur për rëndësinë e platformës, Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, ka theksuar se Kosova po kalon një periudhë të vështirë, prekur nga kriza socio-ekonomike, e cila, pa u dhënë shansi të rimëkëmbet plotësisht nga pandemia, u përkeqësua edhe më tej nga trazirat aktuale globale. "BOOST x Kosova do të ofrojë një zgjidhje të shpejtë dhe gjithëpërfshirëse për bizneset e vogla dhe të mesme, duke i ndihmuar ato të rimëkëmben nga Covid-19 përmes



tranzicionit të gjelbër", ka deklaruar Suokko.

I ngarkuari me punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë, Keisuke Yamanaka, ka theksuar se 'Boost' synon t'i zhvillojë kapacitetet e rreth 50 kompanive private, me

potencial për të krijuar qëndrueshmëri mjedisore dhe rimëkëmbur nga pandemia përmes praktikave të gjelbra. Uranik Begu, drejtor ekzekutiv i ICK-së, ka thënë se programi 'Boost x Kosova' jo vetëm që do t'i ndihmojë bizneset nga

perspektiva e të bërit biznes, mirëpo do të punojë ngushtë me to për t'i përshpejtuar qëllimet e tyre drejt një të ardhme të qëndrueshme. "Duke i bërë bizneset pjesëmarrëse lidere në promovimin e praktikave të

gjelbra dhe të qëndrueshme të bërit biznes, kjo nuk është e rëndësishme vetëm për rritjen e tyre, por edhe për komunitetet në të cilat ato veprojnë", ka thënë Begu.

'Boost x Kosova' u mundësua përmes nismës së UNDP-së "Premtimi klimatik": Projekti për rritje përmes rimëkëmbjes së gjelbër dhe të drejtë nga Covid-19, financiar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë së Japonisë, synon t'i adresojë sfidat e sektorit privat në Kosovë dhe mundësitë e rritjes përmes praktikave të gjelbra. Thirrja është e hapur për të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me zgjidhje inovative që promovojnë praktika të qëndrueshme, efijente dhe ekologjike. Gratë ndërmarrëse inkurajohen fuqishëm të aplikojnë dhe ta integrojnë inovacionin dhe teknologjinë në bizneset e tyre, duke krijuar vende të reja pune dhe rimëkëmbur ekonominë e Kosovës nga pasojat e pandemisë.

Mbi 120 minatorë të kombinatit Trepça mbesin të ngujuar, shkak defekti me rrymë

MITROVICË, 27 SHTATOR - Mbi 120 minatorë kanë mbetur të ngujuar në minierën e kombinatit Trepça. Lajmin e ka konfirmuar të martën kryetari i Sindikatës së Punëtorëve në këtë ndërmarrje, Gani Osmani, duke shtuar se kjo ka ardhur

si shkak i defektit me rrymë. Ai shton se deri më tani nuk raportohet për ndonjë të lënduar. "Ndërrimi i parë ka mbetur i ngujuar që nga ora 07:00. Kjo ka ndodhur për shkak të defektit me rrymë, e cila është shkaktuar nga rrufeja. Ekipet e KEDS-it

janë duke punuar për ta mënjanuar defektin. Aktualisht janë 123 punëtorë të ngujuar, pra tri horizontet e ndërrimit të parë. Për momentin nuk raportohet për ndonjë të lënduar dhe të gjithë janë mirë", ka thënë Osmani.



Të çmendur? Bethoven, Moxart, Pikaso, Van Gog, pse gjenitë nuk janë asnjëherë normale

Bethoven, Moxart, Pikaso, Van Gog: e vështirë shumë që t'i imagjinosh si metodikë dhe të rregullt. Sepse gjenialiteti "nuk është normal". Gjenitë na pëlqejnë kështu: ekstravagantë, të pavëmendshëm, mbi rregullat. Ndoshta sepse normaliteti pak u përshtatet mendjeve të shkëlqyera. E megjithatë shkenca sot është në gjendje të përgënjeshtrojë stereotipet më të përhapur. Njërën pas tjetrit...

I marrë, rebel dhe i izoluar. "Gomar" në shkollë, i pavëmendshëm, skorbutik. Janë të gjithëtribute që duket se shkojnë shumë mirë me gjenin. Kush nuk e ka në mendje pamjen e Ajnshtajnit? Apo shpërthimet e karakterit të Moxartit dhe Van Gogut? E megjithatë, jeta e mendjeve të mëdha të të kaluarës përgënjeshtrojnë pothuajse gjithmonë stereotipet. Duke filluar nga ai më i zakonshmi, sipas të cilit inteligjencat e jashtëzakonshme shoqërohen pothuajse gjithmonë me marrëzinë. "Biografet shkojnë dhe nxjerrin në pah dobësitë e karakterit të gjenive, duke krijuar përshtypjen që ata janë psikologjikisht të brishtë", thotë Cesare Cornoldi, docent i Psikologjisë në Universitetin e Padovës dhe autor i shumë librave mbi inteligjencën dhe të kuptuarit; "ne besojmë sepse imagjinata jonë zakonisht goditet më shumë prej përjashtimi në jetën e këtyre personave, se sa nga normaliteti". Më pas, për të përforcuar këtë ide shërbejnë historitë ekzemplare, si ajo e matematicienit të madh rus Grigorij Perelman, i cmendur pasi zgjidhi supozimin e Poincaré, të cilin shkencëtarët përipiqeshin ta zgjidhnin prej një shekulli. Pasi refuzoi një cmim prej një milionë dollarësh që iu ofrua nga Clay Mathematics Institute në Cambridge, dhe nuk u paraqit që të marrë medaljen Fields, shpërblimi më i lartë që i njihet një matematicieni, Perelman jeton sot në varfëri bashkë me nënën e tij të moshuar në një lagje famëkeqe të Shën Petërburgut, bishet si barbon dhe refuzon cdo lloj kontakti me ata që kërkojnë t'i afrohen. E megjithatë, rasti i tij është përjashtim më shumë se sa një rregull. Tre studiuesit e tjerë që fituan medaljen Fields bashkë me të janë tashmë profesorë universitetesh të afirmuar. Ashtu sikurse dhe 50 matematicienët që e kanë marrë këtë cmim nga viti 1936 e deri sot, të cilët kanë mbuluar të gjithë detyra të rëndësishme akademike.

Pakëz marrëzi


Por klishtëtë përgënjeshtrohen mbi të gjitha prej numrave të mëdhenj. Si ata të një studimi të Karolinska Institute në Stokholm, që ka marrë në pyetje të gjithë popullsinë suedeze me objektivin për të verifikuar nëse me të vërtetë nivele të rritur të krijueshmërisë dhe inteligjencës janë më të zakonshëm mes të sëmureve psikiatrikë se sa mes popullsisë në

përgjithësi. Përgjigja është jo. Jo vetëm nuk ka asnjë lidhje mes gjenisë dhe sëmundjes mendore; por përkundrazi, thuhet në studim, "mendjet krijuese kanë një probabilitet më të vogël që të vuajnë nga skizofrenia, depresioni, cregullimet e ankthit, autizmit, mungesës së vëmendjes, abuzimit me alkool dhe drogë, apo për të kryer vetëvrasje". Dhe motivi është cuditërisht banal. "93 përqind e personave që kanë ndonjë mani thonë se kanë vështirësi për të cuar përpara një projekt", shpjegon Simon Kyaga, që ka koordinuar studimin. "Sëmundja mendore në fakt kompromenton motivimin dhe ambicijen, cilësi që janë në fakt thelbësore për të arritur suksesin personal".

Duke thënë këtë, Kyaga përgënjeshtrojnë edhe një tjetër klishe mes gjenive: atë pra, që atyre u vjen gjithçka e lehtë, për shkak të ndonjë aftësie pothuajse të mbinatyrshme. Nuk është aspak e vërtetë. Për të pikturuar Les demoiselles d'Avignon Pikaso bëri më shumë se 500 boca. Ajnshtajni u mor 9 vjet me elaborimin e teorisë së relativitetit të përgjithshëm duke nisur nga relativiteti i ngushtë botuar në 1905. Dhe Carls Darwin punoi me idenë e tij të evolucionit për disa dekada përpara se të mbërrinte në formulimin përfundimtar, në 1859. Giacomo Leopardi, i rishkruante vargjet e tij dhjetëra herë për të gjetur kombinimin e duhur mes tingullit dhe kuptimit.

Të keqkuptuar dhe rebelë

Pra, angazhimi është themelor me qëllim që talenti të afirmohet dhe të njihet, gjë që zakonisht ndosh shumë shpejt. Pavarësisht mitit të krijuar për gjenin e keqkuptuar dhe që nuk ka shkuar mirë në shkollë, në të vërtetë "në shumicën e rasteve gjenialiteti identifikohet dhe kultivohet që në fazën e fëmijërisë", thotë Katherine Uollett, studiuese e University College në Londër. Shembujt janë të shumtë. Moxarti – që kishte padyshim një farë cregullimi të personalitetit – ka qenë një gjeni muzikor që kur ishte fëmijë. Dhe aftësia jashtë të zakonshmes në dizejnim dhe në pikturë nisi që të shfaqet shumë herët edhe tek Pikaso dhe tek Leonardo Da Vinci. Shkrimtari i ardhshëm gjerman, Wolfgang Gëte (i cili ka patur një kuocient të inteligjencës, të vlerësuar aposteriori, prej 210, pra më i larti i historisë), shkëlqente që fëmijë në të gjitha lëndët, dhe që në moshën





15-vjecare ai njihete dhe fliste shumë mirë latinishten, greqishten, frëngjishten dhe italishten, i binte pianos, ishte shumë i aftë në skermë dhe në kalërim. Dhe në fund Ajnshtajni ka qenë gjithmonë i zoti në matematikë dhe në fizikë, dhe ai u përjashtua në provimin e parë për pranimin në Politeknikun e Zyrihut përpara se ngelej pas në lëndët e tjera.

Sigurisht, përjashtimet ekzistojnë: Stephen Hawking dhe Alessandro Manzoni, respektivisht fizikani më i madh që është ende gjallë dhe një prej shkrimtarëve më të mirë italianë, konsideroheshin si dembelë nga mësuesit e tyre. Ndërkohë që Carls Darwin, i detyruar që të regjistruhej për mjekësi, mungonte në leksione për të kaluar ditët në mes të natyrës dhe në ajër të pastër. Edhe në këtë rast, megjithatë, është e vështirë të flasësh për "gomerë": bëhet fjalë më shumë për talente që e konsideronin shkollën shumë të lehtë, apo që – në rastin e Darvinit – ishin të vendosur që të ndiqnin priren e tyre, pavarësisht kostos, që ishte përplasja me prindërit dhe konvencionet sociale.

Prej rastesh të tillë ka rezultuar miti i gjenit rebel dhe të izoluar, edhe ky fals. Në fakt, pasi kanë gjetur rrugën e tyre, të mëdhenjtë e të kaluarës zakonisht janë ndërfutur shumë mirë në shoqëri, dhe risitë e zbulimet tek të cilat ata kanë qenë protagonistë kanë ardhur edhe prej përbaljes me artistë apo shkencëtarë të tjerë. Asnjë zbulim nuk vjen krejt papritur, nga fija e flokut. Ka qenë kështu për Leonardon, i cili jetoi në një periudhë kur inxhinieria po pësonte një zhvillim shumë të madh, për Ajnshtajnin i cili nisi nga zbulimet e fizikanëve të tjerë të fillimit të Nëntëqindës, për Galileon, që mbante lidhje të ngushta me astronomët e kohës së tij, dhe për shumë të tjerë.

Super mendje

E megjithatë, pasi përgënjeshtrohen stereotipet, mbetet fakti që duhet të ketë dicka të vecantë në personalitetin e gjenive. Një kuocient inteligjence shumë më i madh se sa mesatarja nuk mjafton dhe madje, në disa raste nuk është as i domosdoshëm.



"Inteligjenca e lartë dhe gjenia nuk identifikohen", shpjegon Cesare Cornoldi. "Gjeniu ka shpesh por jo domosdoshmërisht një inteligjencë të lartë, ndërkohë që duhet të zotërojë në një masë të madhe talente specifike, të kombinuara me tipare krijuese dhe me karakteristika si vazhdimësia, bindja në mjetet dhe në objektivat e veta. Është bërë një studim mbi biografitë e njerëzve të famshëm, dhe mes karakteristikave të gjetura ka qenë një aftësi e jashtëzakonshme për të punuar në kushte të vështirë dhe bërë punë të vështira, interesa të gjerë, kundërshtim i dogmave dhe një vetëvlerësim shumë i lartë". Gjithë kësaj i shtohet pastaj praktikimi konstant i materisë në të cilën shkëlqen, aftësia e jashtëzakonshme për të mbledhur detaje dhe papajtuueshmëri, si dhe aftësia për t'u përqëndruar për një kohë të gjatë në një problem specifik. Këto tre vecanti ndeshen edhe tek autistët, dhe kanë bërë të mendohet që këta të fundit zotërojnë një inteligjencë që shkon përtej të zakonshmes.

Tema është delikate, dhe është sigurisht e vërtetë që disa individë autistë, të ashtuquajturit savant, janë shumë të aftë në dizejnim, apo kanë aftësi matematikore si dhe një memorie të jashtëzakonshme. Megjithatë, kërkimet mbi këtë temë kanë priren që të përjashtojnë që bëhet fjalë për gjenialitet, dhe nënvizojnë rëndësinë e praktikës ngulmuese në plazmimin e trurit dhe për ta bërë atë shumë efikas në zhvillimin e një detyre të caktuar. Dicka e ngjashme u ndodh taksistëve të Londrës, që për të marrë licencën duhet të demonstrojë se njohin përmendësh pothuajse 25 mijë rrugët e kryeqytetit britanik si dhe adresën e pothuajse 20 mijë vendeve. Aftësia e jashtëzakonshme e taksistëve të Londrës nuk është në fund të fundit shumë e ndryshme nga ajo e savant-ëve, por nuk mjafton sigurisht për t'i bërë ata gjeni.

Ka persona me aftësi të jashtëzakonshme, kujtesë të pabesueshme, aftësi matematikore dhe artistike të paimagjinueshme për njerëzit e zakonshëm. Origjina e këtyre aftësive është një prej mistereve të shumtë që rezervon ende truri i

njeriut. "Shumë prej këtyre personave me aftësi të veçanta vuajnë nga autizmi apo një gjendje e caktuar e sindromës savant", shpjegon Carlo Alberto Marzi, i departamentit të shkencave neurologjike, neuropsikologjike, morfologjike dhe motore të Universitetit të Veronës. "Por nuk është kështu për të gjithë. Jill Price, për shembull, ka një kujtesë autobiografike të pabesueshme, por nuk shfaq asnjë shenjë autizmi dhe ka një jetë normale. I tiji është ndoshta rasti më misterioz". Sindroma savant është një gjendje shumë e rrallë në të cilën persona me cregullime të rëndë mendorë kanë aftësi të jashtëzakonshme në disa fusha, që krijojnë një kontrast të fortë me paaftësinë e tyre për të kryer veprime që për të tjerët janë normale. Lidhet shpesh me autizmin, por jo të gjithë ata që kanë sindromën savant janë edhe autistë: ndonjëherë vuajnë nga shqetësime të tjerë apo dëme të sistemit nervor. "Nuk dihen shumë gjëra për këtë sindromë", vazhdon Marzi. "Ekziston hipoteza që, nëse ka probleme diçka në mekanizmat vetërregullues të trurit, mund të manifestohen fenomene të veçantë. Në mungesë të të dhënave të sakta shkencore, krijohet përshtypja që prania e një anomalie të rëndë arrin që, në disa raste, "të çlirojë" funksione që më parë janë mbajtur nën kontroll".

Po tek muzika, Tony DeBlois është një muzikan jo i zakonshëm. Ka nisur të luajë muzikë kur ishte vetëm 2 vjeç, në garazhdin e shtëpisë, me një organo të vogël. Sot është në gjendje të luajë në nivele të ndryshëm 22 instrumenta, që nga piano tek violina, nga fizarmonika tek saksofoni, nga flauti indian tek kitara. Një aftësi mbresëlënëse, sidomos kur mendon që DeBlois është i verbër që në lindje dhe që në moshën 5 vjeç u diagnostikua me autizëm. Në vijim, kur ishte 15 vjeç, u njoh si savant i lindur. Pavarësisht verbërisë dhe shqetësimeve të tjerë prej të cilëve vuan, të cilët i kufizojnë aftësitë sa i përket kryerjes së veprimtarive të përditshme, është diplomuar me nota maksimale në një shkollë prestigjioze muzike në Boston. Luan kryesisht jazz dhe është veçanërisht i zoti në improvizim: veç kësaj, ka një kujtesë të jashtëzakonshme për muzikën dhe luan përmendësh 8000 këngë. Është një muzikant i suksesshëm, i njohur edhe jashtë SHBA.

Në fakt, një studim anglez ka demonstruar se kjo aftësi është e lidhur me një zhvillim më të madh të zonave të trurit që janë përgjegjëse për kujtesën. Dhe një fenomen i ngjashëm është vërejtur tek violinistët, që kanë më të zhvilluar një zonë të korteksit të trurit që drejton gishtat e dorës së majtë, me të cilët preken kordat. Natyrisht ka qenë kështu edhe për Paganinin. Por gjenialiteti i tij varej nga tjetër gjë. /Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina dhe Drita kërkojnë pikët e plota në 'Fadil Vokrri'

Ndeshje e jashtëzakonshme do të zhvillohet sonte (e mërkurë) në stadiumin "Fadil Vokrri" në mes të Prishtinës dhe Dritës. Të dyja këto dy klube kanë paralajmëruar se do të luajnë për fitore, derisa edhe interesimi për ta përcjellë këtë ndeshje është i madh

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - FC Prishtina është përgatitur maksimalisht për ta fituar derbin kundër Dritës që zhvillohet sonte (e mërkurë) nga ora 19:00. Fillimisht trajneri Ismet Munishi ka thënë se kryeqytetasit do të tregojnë se sa e madhe është Prishtina. "Të mërkurën do të tregojmë se sa e madhe është Prishtina, sepse 'rrethet' kanë filluar ta çojnë kokën si shumë. 'Plisat' do të bëjnë atmosferë siç i ka hije klubit më të madh shqiptar", ka thënë Munishi. Ndërsa sulmuesi Kreshnik Uka ka paralajmëruar se tri pikët do të mbesin në kryeqytet. "Jemi të vetëdijshëm se e kemi përballë një skuadër shumë cilësore e që mendoj se është një ndër ekipet më të kompletuara në Superligë andaj këtij takimi duhet t'i qasemi me kujdes maksimal. Brenda grupit atmosfera është shumë e mirë ndërmjet futbollistëve në krye me trajnerin

Ismet Munishi, i cili gjithmonë na qëndron afër për çdo gjë. Gjithmonë kur luan në shtëpi është tjetër ndjenjë. Është vetëm ndeshja e dytë që e zhvillojmë në 'Fadil Vokrri' pasi kemi pasur orar të papërshtatshëm për ndeshjet si vendas dhe kemi qenë të penalizuar. Gjithsesi, Prishtina në çdo stadium që luan gjithmonë e ka objektiv fitoren dhe me ndihmën e 'Plisave' çdoherë shpresojmë se do t'ia arrijmë qëllimit. Do Zoti që t'i gëzojmë me fitore tifozët tanë. Edhe në këtë ndeshje premtoj maksimumin dhe kur jep gjithçka nga vetja atëherë edhe goli shpresoj se do të vijë", ka thënë Uka.

Optimizëm për ndeshjen e radhës kanë shfaqur edhe në kampin e skuadrës gjilanase. Trajneri Ardian Nuhui ka thënë se Prishtina ka skuadër të mirë, por motivi të futbollistët e tij është i madh për të shfaqur një ndeshje të madhe. "Kemi një ndeshje e cila gjithmonë sjell interesim të madh te tifozët dhe për



këtë pres që stadiumi të jetë i mbushur. Kjo është një mundësi e artë për futbollistët tanë për t'i shprehur vlerat e tyre, por edhe për ta parë vlerën e kampionatit që vazhdimisht po rritet. Kundërshtari mendoj se ka futbollistë cilësorë, duke mos harruar që edhe skuadra jonë ka potencial. Motivi të skuadra është i lartë, djemtë mezi presin të dalin në fushë dhe të bëjnë një ndeshje të madhe", ka thënë Nuhui. "Intelektualët' nuk lënë asnjë ndeshje. Ata gjithmonë janë bashkë me ne dhe nuk e diskutoj se do të

jenë në numër të madh edhe të mërkurën për të na mbështetur në maksimum. Besoj se po kënaqen me performancën e djemve, sepse po luajnë futboll cilësor dhe me shumë gola. Uroj që do ta bëjmë maksimumin për të marrë më të mirën", ka thënë Nuhui. Ndërsa mesfushori Rron Broja ka deklaruar: "Atmosfera në këtë moment është jashtëzakonisht shumë e mirë mes lojtarëve dhe në klub, sepse sigurisht kur fiton edhe atmosfera bëhet më e mirë. Besoj se edhe në ndeshjet e ardhshme duhet

të futemi me vetëbesim të madh, sepse kemi zhvilluar ndeshje mjaft të mira në këtë fillim të kampionatit. Kjo duhet të na motivojë në ndeshjet që do të vijë. Kjo duhet të na ndihmojë që ndeshjet e ardhshme t'i marrim me qetësi dhe ta arrijmë maksimumin".

Kjo ndeshje është e javës së tretë në Superligë, derisa Drita është në krye të tabelës me 17 pikë, derisa në vendin e katërt 11 pikë.

Sot zhvillohet edhe ndeshja Malisheva - Ballkani

Skuadra kampione e Kosovës, Ballkani, do ta zhvillojë të mërkurën ndeshjen e shtyrë kundër Malishevës. "Portokallezinjtë" do të udhëtojnë në stadiumin "Liman Gegaj" në Malishevë për duelin e javës së parë e cila ishte shtyrë. "Ndeshja e mbetur në kuadër të xhiros së parë, FC Malisheva - Ballkani, zhvillohet nesër në orën 13:00 në stadiumin 'Liman Gegaj' në Malishevë. Kjo ndeshje ishte shtyrë për shkak të ndeshjes sonë në kuadër të Ligës së Konferencës", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Ylli, në grup të vështirë në FIBA Europe Cup



SUHAREKË, 27 SHTATOR - Kampioni i Kosovës në basketboll, Golden Eagle Ylli, pasi nuk arriti të kualifikohet në grupet e Ligës së Kampionëve, duke u mundur nga Benfica, do të garojë në grupet e FIBA Europe Cup. Kjo do të jetë hera e parë që skuadra therandase do të jetë pjesë e kësaj gare.

Ndeshja ndaj portugezëve ishte debutimi për Yllin në garat evropiane. Ylli do të jetë në Grupin A, ku bën pjesë edhe Hapoel Galil nga Izraeli dhe dy skuadrat gjermane Brose Bamberg dhe Niners Chemnitz. Grupi shihet i vështirë për kampionët e Kosovës, por që duan të bëjnë

paraqitje në arenën ndërkombëtare. Sigal Prishtina, nëse depërton në grupe, do të jetë së bashku me Happy Casa Brindisi, Donar Groningen dhe BC Budivelnyk Kyiv, kurse Trepça, nëse arrin të kalojë në grupe, do të përballet me Anwil Wloclawek, Karhu Basket dhe Egis Kormend.

Bardhi: Duhet të jemi më seriozë, tifozët meritojnë më shumë

SHKUP, 27 SHTATOR - Kapiteni i përfaqësueses së Maqedonisë, Enis Bardhi, pas ndeshjes me Bullgarinë, ka shprehur mirënjohjen ndaj tifozëve për mbështetjen e madhe nga tribuna. Bardhi regjistroi paraqitjen e tij të 50 me fanellën e kombëtares dhe pas ndeshjes me një dozë autokritike për veten dhe shokët e skuadrës, bëri thirrje të gjithëve që të mendojnë me kujdes për sjelljet serioze dhe të përgjegjshme në çaste të caktuara në fushë. "E di që nëse shikojmë realisht kemi merituar më shumë nga këto ndeshje, por duhet të them gjithashtu se pas

gjithçkaje që na ka ndodhur, secili prej nesh, duke filluar nga unë, duhet të mendojë mirë përpara se të vijë në takimin e radhës dhe duhet të jemi më seriozë dhe më të përgjegjshëm në fushë, sepse ua kemi borxh këtyre tifozëve të jashtëzakonshëm. Dua të shpreh një falënderim të madh për tifozët që na mbështetën në masë dhe pas ndeshjes na brohoritën dhe treguan se besojnë shumë te ne. Prandaj ne lojtarët duhet të mendojmë mirë kur performojmë për kombëtares dhe bashkë me publikun duhet të jemi të duruar

sepse kemi një të ardhme përpara dhe suksese të reja mund të arrijmë vetëm së bashku", ka thënë Bardhi. "Një ndeshje e tërë me një lojtar më pak është vërtet e vështirë por, pavarësisht kësaj, në pjesën e dytë realisht patëm disa raste 100% Alioski, Doriev... por, përsëri si në Gjeorgji, nuk i shfrytëzuam. Ne e prisnim shumë ndeshjen me Bullgarinë, por që nga minuta e dhjetë mbetëm me një lojtar më pak dhe kjo prishi shumë gjëra. Në çdo rast, po të shikosh gjithçka, nuk e meritonim humbjen", ka shtuar Bardhi.



Fury anulon duelin me Joshuan: Harrojeni këtë sfidë

LONDËR, 27 SHTATOR - Boksieri britanik Tyson Fury, kampion bote në peshën e rëndë (WBC), deklaroi se dueli ndaj Anthony Joshuas nuk do të zhvillohet, pasi kontrata nuk është firmosur. Ai kishte lënë afat orën 17:00 të ditës së hënë, por deri në atë orë nuk ishte firmosur asnjë kontratë. Joshua kishte

deklaruar se do ta firmoste kontratën për t'u përballur me Tyson Furyn më 3 dhjetor, por asgjë konkrete. Fury ka deklaruar në rrjetet sociale pak orë pasi kishte kaluar ora 17:00 se dueli me Joshuan është anuluar. "Është zyrtare. Dita e skadimit të afatit kaloi. Ishte ora 17:00 e ditës së hënë dhe

asnjë kontratë nuk është firmosur. Ndaj, marrëveshja për duelin me Joshuan është anuluar. Harrojeni këtë sfidë, idiot. Një frikacak. Gjithnjë e kam ditur se ai nuk kishte kredite për t'u përballur me mua. Urime për karrierën tënde dhe jetën tënde!", ka thënë Fury.



Ish-trajneri zbulon sekretin e madh të 'bishës' Haaland

MANCHESTER, 27 SHTATOR - Që të angazhohesh maksimalisht në ligat më të spikatura të futbollit në botë duhet të kesh një përgatitje të veçantë, e cila shkon përtej asaj që është thjesht sportive. Kërkesat janë në rritje dhe një nga eksponentët më bombastik të këtij sporti është Erling Haaland, i cili ka arritur të ketë zakone jashtëzakonisht strikte për të qenë sot një nga lojtarët më të rëndësishëm në planet. Dihet që stërvitja, si në aspektin taktik, ashtu edhe në atë fizik, është e rëndësishme, por kjo duhet të shoqërohet edhe me çështje që lidhen drejtpërdrejt me paraqitjen e mirë në fushën e lojës. Për këtë arsye Erling Haaland ndjek një dietë strikte që e lejon të jetë në gjendje të përkryer për t'i përballur angazhimet e tij të ndryshme, si me Manchester Cityn ashtu edhe me kombëtaren norvegjeze. Në këtë kuptim, ish-trajneri personal i golashënuesit norvegjez Erase Steenslid tregoi të gjitha detajet e dietës që ndjek Haalandi për të arritur atë gjendje të privilegjuar fizike, e cila e ka bërë të dallohet mbi mesataren disa vjet më parë. Kjo dietë përbëhet nga ushqime specifike që janë të favorshme për një futbollist të karakteristikeve të tij. Sipas Steenslid, ish-futbollisti i Borussia Dortmundit, ka meny të



pasur me mish pule dhe makarona, por të gatuar pa kripë e vaj, të cilave ua shton peshkun shpatë, levrekun dhe krapin, të shoqëruar gjithmonë me perime. Sa i përket pijes, konsumon vetëm ujë për ta parandaluar hyrjen e sheqernave të koncentruar në trupin e tij si dhe zgjedh produkte të freskëta në vend të atyre të ngrira. Pikërisht gjatë kohës së tij në Dortmund arriti formën më të mirë, megjithëse për këtë iu desh ta ndryshonte tërësisht mënyrën e të ushqyerit. "Trupi i tij i përgjigjet shumë mirë stërvitjes, sepse ka gjenetikë të privilegjuar. Ai fitoi 12 kilogramë muskuj në 15 muaj, ishte çmenduri. Ne ia ndërtuam muskujt nga e para. Ai ishte gjithmonë llupës, hante një mal me ushqime", ka shtuar ish-

trajneri i Haalandit. Pasi përpiloi rutinën e stërvitjes dhe dietën për sulmuesin, gjithçka ra në vend pothuajse automatikisht. Steenslid ndau një anekdotë qesharake për ato ditë: "Kam projektuar një qark për të, ku në një nga stacionet duhej të godiste një çantë, derisa një ditë e theu atë përgjysmë". Është e panevojshme të thuhet se figurat e tij të jashtëzakonshme në Gjermani zgjuan interesimin e shumë skuadrave nga pjesa tjetër e Evropës, derisa më në fund Pep Guardiola arriti ta përfshijë në radhët e të vetve. Që nga debutimi me "qytetarët", Erling Haaland tashmë ka arritur të shënojë 11 gola në 7 ndeshje dhe të bëhet një nga figurat më të mëdha në Premierë Ligë.

Southgate: Bëmë gabime, por e forcuan grupin këtë javë

LONDËR, 27 SHTATOR - As ai vetë nuk e di se çfarë fjalësh do të kishte bërë bashkë për të justifikuar një rezultat që deri në minutën e 67 ishte 2-0 në favor të Gjermanisë. Barazimi spektakolar në "Wembley" duket se e çliron edhe Gareth Southgate nga presioni i ditëve të fundit. Dhe në përfundim të këtij edicioni të Ligës së Kombeve për skuadrën e tij, anglezi pranon se pas këtij momenti të vështirë skuadra do të reflektojë dhe e ka bërë që këtë javë me karakterin që tregoi kundër Gjermanisë. "Si grup, skuadra është bashkuar këtë javë. Ka qenë një periudhë e vështirë për ta. Ata janë rritur. Po i drejtohem Kupës



së Botës dhe në një pikë ti do të ekspozohesh ndaj presionit. Këtë javë ne kemi mësuar shumë. Lojtarët kanë bërë një hap përpara dhe si grup janë bashkuar më shumë", ka thënë Southgate. Në lidhje me ndeshjen ai pranoi se

ishin gabimet e Anglisë ato që sollën golat e rivalëve. "Në këtë ndeshje bëmë disa gabime që na kushtuan golat e pësuar, por unë jam i fokusuar në faktin se lojtarët tanë luajtën me një shpirt të jashtëzakonshëm. Ata treguan besimin që nuk e kishim parë në ndeshjet e fundit. Mendoj se tifozët e mbështetën skuadrën. Poup gaboi sigurisht. Morali i tij është në tokë, por skuadra duhet të qëndrojë bashkë për atë që ka bërë këtë javë. Nuk duhet të ndalemi te gabimet individuale, por te gjërat pozitive dhe bazën që duhet ta shfrytëzojmë për t'u përmirësuar në prag të Botërorit", ka shtuar Southgate.

SHKURT

Barçës i lëndohen katër futbollistë në ndeshjet e kombëtareve

Barcelona ka pësuar më shumë nga të gjitha skuadra nga ndeshjet e kombëtareve në këtë muaj. Memphis Depay dhe Frenkie de Jong e kanë paguar shtrenjtë, ashtu si Kounde dhe Araujo që u dëmtuan më herët. Të dy holandezët u janë nënshtruar testeve mjekësore me Barçën, të cilat kanë konfirmuar shqetësimet. Klubi katalanas përmes një deklarate ka raportuar shqetësimin se nuk janë në dispozicion të trajnerit Xavi, por nuk ka treguar kohën e parashikuar që duhet të qëndrojnë larg fushave të lojës. Dy lojtarët holandezë kanë humbur rolin e titullarit në këtë sezon dhe tashmë vijnë edhe dëmtimet.

'Google' zbulon finalistët e Kupës së Botës në Katar

Kupa e Botës në Katar do të fillojë më 20 nëntor dhe gjiganti i teknologjisë "Google" tregoi fuqinë masive informatike që qëndron pas motorit të tij të kërkimit duke parashikuar të ardhmen, më konkretisht se kush do të luajë në finalen e turneut. Nëse kërkoje "Lusail stadium event" në "Google", në një nga rezultatet e kërkimit ishte edhe finalja në mes të Brazilit dhe Francës. Në fakt, të dyja kombëtares janë ndër favoritët e këtij evenimenti që do të mbahet në Katar.

Cassano: Ronaldo duhet të tërhiqet

Ish-sulmuesi i Romës dhe Real Madridit, Antonio Cassano, vazhdon ta sulmojë Cristiano Ronaldon, madje këtë e bën çdo javë në rrjetet sociale në një komunikim me Bobo Vieri. Ish-futbollisti i njohur këtë herë ishte edhe më i ashpër për sulmuesin ku, sipas tij, duhet të tërhiqet pasi nuk ka çfarë të japë më. "Ronaldo ka frikë të tërhiqet, në fakt bëhet fjalë për frikën që kanë të gjithë fenomenët. Ka fituar gjithçka në karrierën e tij, gjithashtu ka fituar edhe shumë para, ka qenë një fenomen, padyshim. Por, boll më, tashmë është kthyer në një lojtar stoli. Duhet të tërhiqet", ka thënë Cassano.

Ter Stegeni nuk e komenton zbritjen e rrogës te Barça

Marc-Andre Ter Stegen ishte një prej protagonistëve më të mëdhenj të sfidës ndërmjet Anglisë dhe Gjermanisë. Edhe pse i pësoi tre gola, portieri i Barcelonës e bëri një lojë të madhe, me disa pritje vendimtare. Në fund të ndeshjes ka folur portieri gjerman për "El Larguero", duke iu përgjigjur pyetjeve rreth kontratës me "Blaugrana". "Zvogëlimi i rrogës? Nuk besoj se është momenti për të folur për këto gjëra. Kemi nevojë për të gjithë që t'i përmirësojmë paraqitjet tona dhe të përballemi sa më mirë me angazhimet dhe sfidat që i kemi në Kupën e Botës", ka deklaruar Ter Stegen. Shkaku i krizës financiare, Barcelona ka paralajmëruar se mund t'ua ulë pagat lojtarëve, sidomos atyre kryesorë që i kanë më të lartat.

Agbonlahor: Nunezi, transferimi më i dështuar i këtij sezoni në Premierë Ligë

Darwin Nunez u transferua nga Benfica te Liverpooli gjatë verës për shifrën e 100 milionë euro. Sulmuesi u konsiderua një nga lojtarët që do ta bënte diferencën te

"The Reds", por në javët e para të Premierë Ligës nuk ka mundur të japë atë që drejtuesit presin. Ish-sulmuesi i njohur i Aston Villës, Gabby Agbonlahor, e

ka kritikuar Nunezin duke e cilësuar atë si një transferim të dështuar, pasi u pyet se cilin lojtar e cilësonte si të tillë dhe që ka zhgënjyer në këtë fillim sezoni. "Kur

shikoj edhe Nunezin, ndihem sikur edhe prekja e tij e parë nuk është aq e mrekullueshme. Ne shpejt e quanim Lukakun 'Çizme Timberland' kur ishte në

trend në 'Twitter' kur ai kishte prekje të këqija në ndeshje. Nunezi duket sikur ka veshur dy palë 'Timberlands', ka deklaruar ish-lojtari i Villës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 27.2 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 1832 të datës 26.09.2022 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri
Numri i referencës:	AJAFP/ZKA/19-09/22
Grada:	ZKA-A8
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga metodologjia, që t'i mundësojë UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoi njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregojnë gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregojnë integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkojnë nga UE dhe DD i/e tij.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike;
- Certifikatë në njërin nga skemat e certifikimit si teknik kontabiliteti dhe asistent-auditor i sektorit publik.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 13.10.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, i člana 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 27.2 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu, (izmenjen/dopunjen) kao i Odluke Generalne Revizorke Br. 1832 datuma 26.09.2022 za popunjavanje slobodnih radnih mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS

za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Položaj:	Junior Revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti;
Broj reference:	AJAFP/ZKA/19-09/22
Nivo:	ZKA-A8
Broj radnih mesta:	Dva (2)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže VT-u u prikupljanju preliminarne informacije o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi revizorskih dosijea i obavlja druge poslove vezanih za reviziju;
- Jasno pisanje u popunjavanju revizorskih radnih dokumenata o adresiranim pitanjima iu skladu sa standardima NKR-a i njihovo blagovremeno dostavljanje VT-u;
- Indeksiranje radnih dokumenata o temama (uzorcima) i revidiranim oblastima i svih dokumenata (uključujući one primljene od subjekata) koje treba da budu u skladu sa formatom i zahtevima navedenim u metodologiji, kako bi se VT-u omogućila lakša revizija;
- Blagovremeno popunjavanje radnih dokumenata, memoranduma o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a da bi se postigli rokovi koje je odobrio menadžment;
- Pružna saradnju i tačne informacije Timu za reviziju, njegovom departmanu i svim drugim sektorima i departmanima u okviru NKR-a;
- Pomaže drugom osoblju tima i departmana, oko revizorskog rada, za korišćenje informacionih tehnologija, pruža podršku VT-u i odgovoran je u sprovođenju zadatka za postizanje objekta tima i departmana;
- Dobra komunikacija sa članovima tima sa osobljem VT-em, DD-em, NKR-om i osobljem subjekata tokom revizije;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-em i DD-em tokom procene učinka za prethodnu godinu, kao i za pohađanje obuka koje organizuje NKR u vezi sa kontinuiranim profesionalnim usavršavanjem i obrazovanjem;
- Pokazuje visok integritet i poštuje Kodeks etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
- Obavlja i druge profesionalne zadatke koje se mogu zahtevati od VT-a i DD-a.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi;
- Sertifikat u jednoj od šema sertifikacije kao računovodstveni tehničar i pomoćnik-revizor u javnom sektoru.

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, zadnji rok za podnošenje dokumentacije je 13.10.2022 do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručnju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 9 korrik 2020 dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022, të datës 15 shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Bashkëpunëtor Profesional, pesëmbëdhjetë (15) vende pune

Prokuroria Themelore Prishtinë, dy (2) pozita
Prokuroria Themelore Prizren, pesë (5) pozita
Prokuroria Themelore Pejë, tri (3) pozita
Prokuroria Themelore Mitrovicë, dy (2) pozita
Prokuroria Themelore Gjakovë, dy (2) pozita
Prokuroria Themelore Gjilan, një (1) pozitë

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 023
Emri pozitës: Bashkëpunëtor Profesional
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave: Pesëmbëdhjetë (15)
Koeficienti: 9
Akti i emërimit: Pa afat
Puna provuese: 12 muaj
Vendi: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan

Qëllimi i vendit të punës:

Bashkëpunëtori profesional, ofron mbështetje profesionale për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë të prokurorit të shtetit, përmes hulumtimit, këshillimit dhe hartimit të akteve ligjore në fushëveprimtarinë e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillim dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e procedurave përkatëse, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
Kryen detyrat e parapara me plan të punës të miratuar në përputhje me ligjin, rregulloret, politikën dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
Bënë hulumtime ligjore, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandon për shqyrtim dokumentacionin me mbikëqyrësin e lëndës detyrën dhe aktet e specializuara për miratim,
Mbështetë prokurorët në ushtrimin e funksionit të tyre;
Merr pjesë në cilësinë e ekspertit në seanca dëgjimore dhe në seanca gjyqësore kur kjo i kërkohet;
Kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare lidhur me lëndët dhe informatat të cilat i bëhen të ditura gjatë punës;

Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës edhe me autoritetet e jashtme, gjithnjë duke u kujdesur për paraqitje të denjë të institucionit;
Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga fusha Juridike;
Njohuri të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.).

Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve, hartim të propozim akuzave, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Fakulteti Juridik.
Provimi i Jurisprudencës.

Përvoja e punës:

Tre (3) vjet përvojë pune profesionale.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data 28.09.2022 deri me datë 12.10.2022 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
 - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës;
 - Dëshmi e trajnimeve;
 - Dy rekomandime (nëse keni);
 - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
 - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
 - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2021 od 15 Februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljuje:

KONKURS

I. Stručni Saradnik, petnaest (15) radno mesto

Osnovno Tužilaštvo Pristina, dve (2) pozicija
Osnovno Tužilaštvo Prizren, pet (5) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Peć, tri (3) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Mitrovica, dve (2) pozicija
Osnovno Tužilaštvo Đakovica, dve (2) pozicija
Osnovno Tužilaštvo Gnjilane, jedna (1) pozicija

Referenca : Kodi: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ - 023
Naziv Pozicije: Stručni Saradnik
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni
Raportira kod: Administrator Tužilaštvo
Broj Pozicija: Petnaest (15) pozicije
Koeficijent: Devet (9)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: 12 meseci
Mesto: Pristina, Prizren, Peć, Mitrovica, Đakovica, Gnjilane

Cilj radnog mesta:

Stručni saradnik, pruža stručnu podršku u obavljanju poslova i odgovornosti državnog tužioca, kroz istraživanje, konsultacije i izradu pravnih akata iz oblasti delatnosti državnog tužioca.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Razvije i dostiže saglasnost za radne planove i rokove, u koordinaciji sa nadzornikom, za sprovođenje dotičnih postupaka, usluga i proizvoda u specifično stručno polje;
Vrši predviđene dužnosti planom rada usvojenog u saglasnosti sa zakonom, pravilnicima, politikama i relevantnim procedurama, unutar vremenskih rokova;
Vrši istraživanje, analize, procenu opcija i preporučuje pretres dokumentacije sa nadzornikom predmeta, dužnost i specijalizovana akta za usvajanje;
Učestvuje u svojstvu stručnjaka na saslušanjima i sudskim ročištima kada mu se ovo zatraži;
Pobrinjava se za očuvanje službene tajne u vezi predmeta i informacija do kojih dolazi tokom rada;
Podržavaju tužioce u vršenju njihovih funkcija;

Koordinira rad sa ostalim jedinicama institucije i komunicira po potrebi i sa spoljnim autoritetima, uvek brineći se za dostojanstveno predstavljanje institucije;
Vrši svaku drugu dužnost u specifičnu stručnu oblast u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koja se povremeno može zatražiti na razuman način.

Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:

Sveobuhvatna odlična stručna poznavanja iz oblasti prava;
Dobra poznavanja rada na računaru sa primenom programa (Microsoft Word, Excel, Power Point, i dr).
Sposobnosti za razmatranje predmeta, izradu predlog optužnica, optužnica i ostalih potrebnih spisa; Spreman da radi za ljudima raznih nacija i religija;
Sposobnosti za preduzimanje konkretnih inicijativa tokom rada i u vezi istog;
Sposobnosti održanja kvaliteta rada u uslovima rada pod tenzijom;
Stručna sprema i kvalifikacija:
Univerzitetaska Diploma, Pravni Fakultet .
Pravosuđni ispit.
Radno Iskustvo:
3 godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 28.09.2022 do 12.10.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Pristina, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Pristina.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:
 - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
 - "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potorda ili radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvaćaju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dokaz o radnom iskustvu;
 - Dokaz o obukama;
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjuja, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Te Skenda 2022” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811945619 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Te Skenda 2022” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811945619 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Te Skenda 2022” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811945619 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enver Peci shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

- Rima Engineering Group” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-sw, me nr 330270116.

- Marjeta Laksi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të SH.M. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sabri Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. “Shaban Golaj” Lipovec Gjakovë.

- Flora Xhuli nga Juniku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të gjimnazit “Edmond Hoxha” Junik.

- Masters BR-DOO. Shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 811935230.

- Blerim B. Bajrami B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit individual me emrin tregtarë D.P.Z. Auto Ngjyrosës “Buli” me nr. Unik 810934580.

- “Trend Shped” SH.P.K. shpall të pavlefshme Polica e sigurisë së kamionit TPL 0009532850 TPL PLUS 0002214215.

- Shield Recruitment&HR SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811277343

- Hana Nuha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të vitit I, II, III me nr: 1130 të vitit 2000, 1594 të vitit 2001 si dhe 2128 të vitit 2002 drejtimi Elektro Teknik “Naim Frashëri”.

- Larta Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Njëmbëdhjetë të Gjimnazit “Eqrem Çabej” Prishtinë.

- Kolë Vokraj nga Novosella e Epërme kll Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Kushtrim Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hjadar Dushi” Gjakovë.

- Rema Fazli Osmani Fushë Kosovë shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Eqrem Çabej”.

- D.P.T “Beni” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. Të biznesit 70488671.

- Jahë Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Diana Brovina shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Sami Frashëri”.

- Saranda Preniqi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme “Eqrem Çabej” Prishtinë.

- Edonis Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të shkollës së mesme profesional “Prek Jakova” Prishtinë.

- Dr. Qamile Morina shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr: KO-00549-01-01.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

